



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Nr. _____ Prot.

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË
MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (KËSHILLI I MINISTRAVE) DHE QEVERISË SË
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, PËR PROGRAMIN E
SHKËMBIMIT AKADEMIK “FULBRIGHT””**

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright””.

Relatore e projektligjit është znj. Mirela Kumbaro.

Në diskutimin në parim të projektligjit ishin të pranishëm dhe dhanë shpjegime rreth tij zoti Kostandin Shkurti, zv/ministër i MASR, zoti Erzen Tole – drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në këtë ministri.

I.BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

II.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquiscommunaire*.

III.QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues që në fillim theksohet se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje i shërben bashkëpunimit të mëtejshëm të vendit tonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, angazhimi i të cilës në mbështetje të Shqipërisë ka qenë gjithnjë koherent, shprehur qartë dhe përmes këtij memorandum mirëkuptimi, në të cilin të dy qeveritë e të dyja vendeve respektive bien dakord për zbatimin e programit akademik “Fulbright” në arsim, kulturë, shkencë dhe kërkim, me qëllim realizimin e përfitimeve të ndërsjella ndërmjet palëve.

Projektligji është hartuar në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Ky memorandum mirëkuptimi është rrjedhojë e iniciativës së Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë, iniciativë e filluar në fund të vitit 2000 (me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, sipas emërimit të kohës) dhe u rishikua në vitet 2016-2017.

Memorandumi është bazuar në modelin e memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe është paraqitur më pas në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për shqyrtim dhe vlerësim.

Duke patur parasysh misionin mjaft dobiprurës të këtij projektligji, i cili synon nxitjen e mirëkuptimit e të miqësisë së ndërsjellë ndërmjet dy kombeve, nëpërmjet programit të shkëmbimit akademik “Fulbright” në institucionet arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dyja vendet nënshkruese të memorandumit të mirëkuptimit, mundësohet njëkohësisht nxitja dhe inkurajimi i studentëve, personelit akademik, profesionistëve të fushave të ndryshme të vendit tonë për një kualifikim cilësor dhe realizimi i projekteve të përbashkëta sipas fushave përkatëse të përfshira në këtë memorandum.

Programi “Fulbright” i themeluar në vitin 1945, ka mbështetur gjithnjë shkëmbimet arsimore që forcojnë mirëkuptimin dhe komunikimin mes Shteteve të Bashkuara dhe mbi 155 vendeve në mbarë botën, dhe është një formë efektive e prestigjioze e diplomacisë publike.

Përmes këtij programi, nxiten marrëveshjet dypalëshe për t’u fokusuar në prioritetet e përbashkëta të të dyja shteteve në përmbushjen e programeve të dakordësuara, qoftë në ide, mundësi të vëzhgimit të institucioneve politike, ekonomike dhe kulturore të njëri-tjetrit, si dhe për të ndërmarrë projekte të përbashkëta me rëndësi për mirëqenien e përgjithshme. Që nga themelimi i programit, më shumë se 46 000 studentë nga Shtetet e Bashkuara dhe 150 000 studentë nga vendet e tjera kanë përfituar nga përvoja “Fulbright”.

Si një mbështetës i përpjekjeve të diplomacisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, programi i studentëve të huaj “Fulbright” sjell qytetarët e vendeve të tjera në Shtetet e Bashkuara për studime “Master”. Ky studim zhvillohet në universitetet e SHBA-ve ose në institucione të tjera të përshtatshme. Programi ka sjellë disa nga “mendjet më të mira” të botës në kampuset e SHBA-ve dhe u ofron njohuritë pjesëmarrësve të programit në shoqërinë dhe vlerat e SHBA-ve.

Shumë prej graveve të huaja “Fulbright” janë për profesionistë të rinj në karrierë, të cilët do të kthehen më pas për të kontribuar në vendet e tyre, shpesh duke punuar në universitete ose në administratën publike.

Miratimi i këtij projektligji ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ngritjen cilësore të nivelit të studentëve, veprimtarinë e akademikëve, institucioneve përkatëse dhe finalizimin e projekteve të përbashkëta mjaft të rëndësishme për vendin tonë.

Miratimi i këtij projektakti do të sjellë efekte financiare në shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) eurosh, të cilat do të mbulohen nga buxheti i shtetit, për të mbështetur kostot e programit “Fulbright Student”, me qëllim krijimin e më shumë mundësive për studentë, personel akademik dhe profesionistë që marrin pjesë në programin “Fulbright”.

Ky program njëkohësisht do mundësojë thellimin e njohurive të studentëve, studjuesve të fushave të ndryshme për shoqërinë, kulturën, vlerat e kombit amerikan që ka arritur nivelin

më të lartë të qytetërimit botëror. Duke përfutur maksimalisht nga programi *"Fulbright"* institucionet akademike të vendit tonë do forcojnë kurrikulat, do rrisin efikasitetin e kërkimit shkencor dhe do përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies etj., duke sjellë një qasje pozitive për të ardhmen e Shqipërisë.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Për vlerat e shumanshme që përmban arsimimi i brezit të ri, krijimi i kushteve sa më optimale për arsimimin e tyre në nivelin bashkëkohor perëndimor, ratifikimi i kësaj marrëveshje do i shërbejë përsosjes gjithnjë e më shumë të punës të institucioneve që ngarkohen për zbatimin e saj.

Mbështetur në argumentat e mësipërme dhe rëndësinë e marrëveshjes, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik me votat e të gjithë anëtarëve, miratoi projektligjin dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

Mirela KUMBARO

KRYETARE

Fatjona DHIMITRI